



Republika e Kosovës Republika Kosovo • Republic of Kosovo	Institucion i Avokatit të Popullit Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution
Nr./Br./No.	24412022
Nr.i fqj/Br.str./Nr.pg:	24102122
Date/Datum/Date:	



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

**RAPORT  
I  
AVOKATIT TË POPULLIT**

**Ex officio nr. 95/2022**

**Përkitazi me instalimin e kamerave të sigurisë në disa qeli të të  
burgosurave në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan**

**Për:** Z. Albulena Haxhiu, Ministre  
Ministria Drejtësisë  
Z. Ali Gashi, Zëvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm  
Shërbimi Korrektues i Kosovës

**Kopje për:** Znj. Duda Balje, Kryetare  
Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona  
të Pagjetur dhe Petacione

**Z. Habit Hajredini, Drejtor  
Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrat**

**Prishtinë, 24 shkurt 2022**

## QËLLIMI I RAPORTIT

1. Qëllimi kryesor i këtij raporti është térheqja e vëmendjes autoriteteve kompetente të Republikës së Kosovës për respektimin e të drejtave të të burgosurve në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislacionin relevant në fuqi, si dhe standardet ndërkontaktore përmes mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

## BAZA KUSHTETUOSE DHE LIGJORE

2. Sipas nenit 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: “Kushtetuta”), “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga organet e administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”.

3. Sipas Ligjit Nr. 05/L-019 përmes Avokatin e Popullit, nen 16, par. 4, “Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime . . . me iniciativën e vet (*ex officio*), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtresë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkontaktore përmes mbrojtjen e të drejtat e njeriut”.

4. Gjithashtu, Ligji Nr. 05/L-019 përmes Avokatin e Popullit, nen 18, par. 1 përcakton se Avokati i Popullit, mes të tjera, ka edhe këto përgjegjësi:

- “të térheqë vëmendjen përmes rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tillë dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tillë” (pika 2);
- “të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës përmes çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (pika 5);
- “t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (pika 6);
- “të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës” (pika 7);
- “të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit si dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës” (pika 8); dhe
- “t’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkontaktore përmes mbrojtjen e të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv” (pika 9).

5. Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit synon të kryejë këto përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore.

## Faktet e rastit

1. Bazuar në shkrimet e mediave të shkruara dhe elektronike të publikuara më 7 shkurt 2022, se në Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur (*tani e tutje, QKF*), në disa qeli ku mbahen të burgosurat të cilat vuajnë nga probleme serioze shëndetësore mendore, autoritetet e qendrës korrektuese, instaluan kamera të sigurisë. Më 8 shkurt 2022, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, vizituan qendrën në fjalë për të grumbulluar informata më të hollësishme
2. Gjatë vizitës, zyrtarët e Avokatit të Popullit, kanë vërejtur se në disa qeli janë instaluar kamerasë sigurisë në të cilat vendosen të burgosurat me gjendej të rëndë të shëndetit mendorë, të cilat në parim do të duhej të trajtohen në institucionet adekuate shëndetësore. Në rastin në fjalë, zyrtarët e Avokatit të Popullit, kanë vërejtur se kamerat e sigurisë mbulonin vetëm shtretërit dhe dritaret e qelive, nuk mbulonin tualetet, dushet dhe lavamanin. Gjatë vizitës, zyrtarët e Avokatit të Popullit, u njofuan se arsyja e instalimit të kamerave të sigurisë në këto qeli ishte mbrojtja e të burgosurave të cilat përbëjnë rrezik për vetëvrasje për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore.
3. Gjatë vizitës, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, u njofuan se dy zyrtarë të QKF-së janë suspenduar lidhur me çështjen në fjalë. Më 9 shkurt 2022, Avokati i Popullit, kërkoi nga Ministria e Drejtësisë që të njoftohet nëse, për instalimin e kamerave të sigurisë në qeli të të burgosurave, drejtori i qendrës mori ndonjë vendim me shkrim, cila është baza juridike e një vendimi të tillë dhe nëse kjo çështje është e rregulluar me aktet apo procedurat e brendshme të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
4. Më 11 shkurt 2022, përfaqësuesi i Avokatit, komunikoi me Agjencinë për Privatësi dhe Informim, të cilët konfirmuan se më 8 shkurt 2022, kanë kryer një inspektim në QKF, lidhur me çështjen e instalimit të kamerave të sigurisë në disa qeli ku mbahen të burgosurat të cilat kanë probleme serioze shëndetësore.
5. Më 14 shkurt 2022, përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë, e njoftoi Avokatin e Popullit se: “*nuk ka ndonjë vendim nga Drejtoresha e QK në Lipjan dhe SHKK nuk ka ose nuk është në dijeni se ekziston ndonjë vendim apo procedurë e veçantë/akt nënligjor etj., që rregullon këto veprime*”.
6. Më tej në këtë njoftim theksohet: “*SHKK, po ashtu, me 14.02.2022 ka nxjerrë një vendim për lejimin e instalimit të kamerave të sigurisë nëpër institucionet korrektuese për shkaqe të sigurisë dhe rrëthana specifike – për rastet me probleme mendore, duke u bazuar ne Ligjin për mbrojtjen e të dhënavë personale*”.

## Aktet relevante juridike vendore

7. **Neni 36 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës** shprehimisht përcakton: “*Çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohetjeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera.*”
8. *Më tej, sa i përket kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore, në nenin 55 të Kushtetutës, përcaktohet si në vijim:*
  - (1) *Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.*

(2) Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.

(3) Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.

(4) Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.

(5) Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar.

(6) Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.

(7) Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.

9. Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, në nenin 4 shprehimisht përcakton: “Gjatë ekzekutimit të sanksionit penal gjithmonë respektohen të drejtat e personit të dënuar. Këto të drejta mund të kufizohen vetëm në atë masë që është e domosdoshme për ekzekutimin e sanksionit penal në pajtim me ligjin dhe standardec ndërkombe të përdorur përfshira me kufizimin e paajtimit të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të dhënave.”<sup>1</sup>

10. Neni 4 i Ligjit 06/L-082 Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (*tani e tutje, LMDhP*), përcakton parimet themelore të përpunimit të dhënave personale. Neni 4 paragrafi 1 i LMDhP përcakton se parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës nënkuption që të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të dhënave.<sup>1</sup>

11. Ndërsa, neni 4 paragrafi 2 i LMDhP, përcakton që parimi i kufizimit të qëllimit nënkuption që të dhënat personale grumbullohen vetëm për qëllime të caktuara, të qarta dhe legitime dhe nuk mund të përpunohen më tutje në kundërshtim me këto qëllime..

#### Aktet relevante juridike ndërkombe

#### Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)

12. Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se KEDNJ, është pjesë e sistemit juridik dhe kushtetues të Republikës së Kosovës. Për më shumë, aktet ndërkombe të përfshira në këtë nen kanë epërsi në raport me vendimet e institucioneve publike të Republikës së Kosovës.

13. Konventa në fjalë në nenin 8 paragrafi 1 shprehimisht përcakton: “Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij”. Ndërsa në nenin 8 paragrafi 2 të KEDNJ shprehimisht përcaktohet: “Autoriteti publik Shteti nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drekte, përveçse në shkallën e

<sup>1</sup> Ligji Nr. 06/L-082 Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, neni 4 paragrafi 1.

*parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjeraëve”.*

### **Analiza ligjore**

14. Në këtë rast, në QKF, në disa qeli ku mbahen të burgosurat të cilat vuajnë nga probleme serioze të shëndetit mendorë dhe të cilat për shkak të mungesës së kapaciteteve njerëzore nuk u vendosen në institucionet shëndetësore adekuate, autoritetet e QKF, instaluan kamera të sigurisë, me qëllim të ofrimit të mbrojtjes më efektive të të burgosurave nga vetë-lëndimet apo tentimet për vetëvrasje.
15. Avokati i Popullit, duke besuar se, qëllimi i autoriteteve në këtë rast ishe mbrojtja e të burgosurve të cilët përbëjnë rrezik për vetëlëndim apo vetëvrasje për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore, rithekson siç ka theksuar edhe përmes raporteve të mëparshme se, rastet e tillë, duhet të trajtohen në institucione adekuate shëndetësore.
16. Në pikëpamje të të drejtave të njeriut të garantuara me legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës, vendimet e GJEDNJ dhe Standardet e KPT-së, vendosja e kamerave të sigurisë në qeli të të burgosurve, në parim përbën ndërhyrje në privatësinë e të burgosurve, përveç rasteve kur synohet të mbrohetjeta e të burgosurit.
17. Bazuar në vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Standardet e Komitetit Evropiane për Parandalim të Torturës, çështja e instalimit të kamerave të sigurisë në qeli të caktuara, duhet të rregullohet me akte dhe procedura konkrete të cilat ofrojnë garancitë e duhura procedurale të cilat mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.
18. Sa i përket vendimeve të GJEDNJ-së, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 53, shprehimisht përcaktohet se interpretimi i dispozitiveve për të drejtat dhe liritë e njeriut në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
19. GJEDNJ në rastin *Gorolov dhe të tjerët kundër Federatës Ruse<sup>2</sup>* shqyrtoi ankesën e ankuesve të cilët në burgun ku vuanin dënimin u vendosën nën vëzhgim të vazhdueshëm nga kamerat e sigurisë. Gjykata konstatoi se kishte shkelje të nenit 8 të Konventës.
20. Në këtë rast GJEDNJ, në paragrafin 83.1 ndër të tjera thekson: “*Një ndërhyrje e tillë do të përbente shkelje të nenit 8 të Konventës, përveç nëse ndërhyja e tillë ishe “në pajtim me ligjin”, kishte një ose më shumë qëllime legitime të parapara në nenin 2 të atij paragrafi dhe ishte masë e “domosdoshme në një shoqëri demokratike”, për të arritur qëllimin apo qëllimet”.*
21. Në paragrafin 98, GJEDN, ndër të tjera thekson: “*...Edhe pse gjykata është e gatshme të pranojë se duke pasur parasysh kërkeshat e arsyeshme dhe të zakonshme të paraburgimit që do të thotë se mund të jetë e domosdoshme të monitorohen pjesë të caktuara të institucioneve të qendrave të paraburgimit dhe të atyre penale, apo monitorim të të burgosurve të caktuar në baza permanente, përfshirë këtu edhe vëzhgimin me kamera të sigurisë, gjykata gjen se korniza ligjore e tanishme në federatën Ruse nuk mund të konsiderohet se është mjaftueshëm e qartë, precize dhe e detajuar për të ofruar mbrojtje*

<sup>2</sup> GJEDNJ, Rasti Gorolov dhe të tjerët kundër Rusisë, 2 korrik 2019. Shih në:  
[https://hudoc.echr.coe.int/spa#%22itemid%22:\[%22001-194247%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/spa#%22itemid%22:[%22001-194247%22])

*adekuate kundër ndërhyrjeve arbitrale nga ana e autoriteteve në të drejtën e ankuesit për respektimin e jetës së tij private”.*

22. Avokati i Popullit, vëren se në këtë rast, gjykata njoju nevojën për ndërhyrje të tillë në raste të caktuara, kur për këtë ekziston një apo më shumë qëllime legjitime. Megjithatë gjykata këtë e kushtëzoi me ofrimin e garancive procedurale adekuate kundër ndërhyrjes arbitrale në këtë të drejtë, të cilat duhet të jenë të qarta dhe precise.
23. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit, vëren se edhe Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës (*tani e tutje, KPT*), gjatë vizitave në shtete të caktuara, anëtare të Këshillit të Evropës, ka hasur në raste të tillë dhe autoriteteve kompetente u ka rekomanduar veprime konkrete me qëllim të ofrimit të garancive procedurale kundër ndërhyrjeve arbitrale.
24. KPT-ja është mekanizëm i Këshillit të Evropës, i cili monitoron zbatimin e Konventës Evropiane kundër Torturës në vendet anëtare të Këshillit të Evropës. Vendet ku mbahen personat e privuar nga liria e tyre në Republikën e Kosovës monitorohen nga ky mekanizëm që nga viti 2004.
25. **Kështu, në raportin për vizitën në Republikën e Maqedonisë Veriore<sup>3</sup>, KPT-ja, lidhur me vëzhgimin me kamerat e sigurisë në qeli të të burgosurit, ndër të tjera theksoi:** “*KPT-ja është e shqetësuar pasi që nuk kishte asnje rregullativë ligjore e cila do të rregullonte rrëthanat sipas të cilave do të autorizohej një vëzhgim i tillë. Duke pasur parasysh natyrën ndërhyrëse të një vëzhgimi të tillë konstant, është e domosdoshme që të ekzistojnë procedura gjithëpërfshirëse, ndër të tjera, për të rregulluar bazën sipas së cilës mund të autorizohet video vëzhgimi, procedura që duhet të zbatohet dhe kriteret të cilat duhet të përdoren. Përveç kësaj, autorizimi do të duhej të ishte në lidhje me rastet individuale dhe do të duhej ti nënshtrohej rishikimit të rregullt dhe të shpeshtë. Për më shumë, kamerat e sigurisë, nuk mund të zëvendësojnë prezencën aktive të personelit dhe komunikimin interaktiv ndërmjet personelit dhe të burgosurve me çrrregullime mendore. Po ashtu, është esenciale që monitorimi i video kamerave të bëhet në një dhomë të caktuar dhe nga zyrtarë të caktuar dhe jo në një vend “publik” dhe që ngjarjet të regjistrohen në një regjistrer në intervale të rregullta”.*
26. Më tej, në raportin për vizitën në Federatën Ruse<sup>4</sup>, KPT-ja, ndër të tjera thekson: “*KPT-ja njeh se prezencia e kamerave të sigurisë në qeli mund të jetë një garanci e dobishme në raste të veçanta, siç janë rastet kur një person konsiderohet se përbën rrezik për tu vetëlinduar apo për të kryer vetëvrasje. Vendimi për të vendosur mbikëqyrjen me kamera të sigurisë ndaj të burgosurve duhet gjithnjë të bazohet në vlerësimin e rrezikut individual dhe do të duhej të rishikohej në baza të rregullta*”. Vëzhgimi me kamera po ashtu është ndërhyrje e ashpër në privatësinë e të burgosurve dhe vendimi për të imponuar vëzhgimin me kamera të sigurisë ndaj të burgosurit të caktuar gjithmonë do të duhej të bazohej në vlerësimin individual të rrezikut dhe ky vendim të rishikohet në baza të rregullta”. Më tej, KPT-ja, thekson: “*Sa herë që instalohen kamerat e sigurisë në qeli të të burgosurve, ata duhet të informohen plotësisht për këtë veprim të autoriteteve*”.

<sup>3</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti për vizitën në ish Republikën e Maqedonisë, 2006, paragrafi 109. Shih në: <https://www.coe.int/en/web/cpt/north-macedonia>.

<sup>4</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti për vizitën Federatën Ruse, 2012, paragrafi 155. Shih në: <https://www.coe.int/en/web/cpt/russian-federation>.

27. Po ashtu, në raportin për vizitën në Itali<sup>5</sup>, KPT-ja, sa i përket ruajtjes së privatësisë së të burgosurve të cilët i nënshtrohen kësaj mase, ndër të tjera thekson: “*Duhet të ndërmerrën masa për të garantuar që të burgosurve të cilët i nënshtrohen masës së vëzhgimit me kamera të sigurisë, tu garantonhet privatësia e arsyeshme kur ata përdorin tualetin, lavamanin dhe dushin.* Avokati i Popullit, në rastin në fjalë, konstaton se mungon akti normativ konkret me të cilin do të rregullohej vendosja e kamerave të sigurisë në qelinë e të burgosurit dhe i cili do të ofronte garancitë e duhura procedurale nga ndërhyrja arbitrale e autoriteteteve.
28. Avokati i Popullit, mirëpret veprimet e menjëherëshme të Ministrisë së Drejtësisë dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës, për të hetuar çështjen në fjalë dhe miratimin e një vendimi për të rregulluar rastet e tillë, por Avokati i Popullit vëren se ky vendim nuk i përfshinë të gjitha garancitë e përcaktuara nga legjislacioni i aplikueshëm në Republikën e Kosovës, vendimet e GJEDNJ-së dhe standardet e KPT-së.
29. Prandaj, Avokati i Popullit, konsideron se duhet të miratohet një akt nën ligjor konkret, i cili do të përfshinte të gjitha garancitë procedurale të parapara me legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës, vendimet e GJEDNJ dhe standardet e KPT-së, të cekura më lartë.

Në bazë të lartcekurave, dhe në përputhje me nenin 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 18 paragrafit 1, nën-paragrafit 7 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit:

## REKOMANDON

### Ministrinë e Drejtësisë:

- Të miratoi akt nënligjor i cili do të përfshinte të gjitha garancitë procedurale, kundër ndërhyrjes arbitrale në privatësinë e të burgosurve të cilët i nënshtrohen vëzhgimit me kamera të sigurisë në qelitë e tyre, të parapara me legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës, vendimet e GJEDNJ dhe standardet e KPT-së, të cekura më lartë.

Në pajtim me nenin 132, parografi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkua e në pajtim me ligj*” ) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), ju lutemi mirësish të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

  
Me ndërime,  
Naim Qelaj  
Avokat i Popullit

<sup>5</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti për vizitën në Itali, 2012, paragrafi 60. Shih në: <https://www.coe.int/en/web/cpt/italy>.